

22-09-2017

NE EMER TE POPULLIT

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ, Departamenti i përgjithshëm-divizioni penal,** me Gjyqtarin Mustaf Tahiri, duke vendosur në lëndën penale ndaj të pandehurit [REDAKTUAR], nga fshati [REDAKTUAR], Komuna [REDAKTUAR], për shkak të veprës penale Rrezikim i trafikut publik nga neni 378 par.6 lidhur me par.1 të KPRK-ës, duke vendosur lidhur me Aktakuzën e Prokurorisë Themelore ne Ferizaj, Departamenti i përgjithshëm PP.II.nr.1334-2/2015, dt.19.12.2016, dhe kërkesën për shqiptimin e urdhrin ndëshkimesor të paraqitur në Aktakuze, pa mbajtjen e shqyrtimit gjyqësor, me datë 01.02.2017, merrë këtë:

### A K T G J Y K I M

**PRANOHET** kërkesa e Prokurorisë Themelore ne Ferizaj Departamenti i përgjithshëm PP.II.nr.1334-2/2015, dt.19.12.2016, dhe kjo Gjykate i jep këtë;

### URDHER NDESHKIMOR

**I akuzuari;**

[REDAKTUAR], nga i ati [REDAKTUAR], e ëma [REDAKTUAR], e gjinisë [REDAKTUAR], i lindur me dt. [REDAKTUAR], në Gjermani, me vendbanim në fshatin [REDAKTUAR], Komuna [REDAKTUAR], shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, ka të kryer shkollën e mesme, me profesion elektrikist, i gjendjes së mesme ekonomike, mbrohet në liri.

### ËSHTË FAJTOR

**SEPSE:**

Me dt. 08.08.2015, rreth orës 20:10, në rrugën magjistrale Prishtinë-Ferizaj, përkatësisht në fshatin [REDAKTUAR], Komuna [REDAKTUAR], duke drejtuar automjetin e markës “Audi A6”, me targ të regjistrimit [REDAKTUAR], duke vepruar në kundërshtim me dispozitat e nenit 42/1 të LSKRR-së, nga pakujdesia ka ndërmarrveprimin e kyçjes nga rruga dytësore në rrugën kryesore me të cilin veprim ka rrezikuar pjesëmarrësit tjerë në komunikacion, me të cilin rast e goditet me pjesën e përparme të anës së djathtë me pjesën e përparme të anës së majtë automjetin e markës “VW Sharan”, me targ të regjistrimit [REDAKTUAR], me të cilin rast pas dëmeve materiale lëndime të lehta trupore pëson [REDAKTUAR], ndrydhje në krahun e djathtë lëndime këto të përshkruara në ekspertizën mjeko-ligjore,-

**Me çka ka kryer veprën penale Rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 par.6 lidhur me par.1 të KPRK-ës.**

Andaj gjykata ne baze te nenit 4, 7, 17, 41, 46, 73, te KPRK-se, dhe nenit 359, 360, 361, 365, 366, te KPP-se i;

### SHQIPTON

**DENIMIN ME GJOBË** në shumë prej 200€ (dyqindeuro), të cilin dënim do ta paguaj pas plotfuqishmërisë se këtij aktgjykim.

Nëse i akuzuari nuk e paguan gjobën në afatin e caktuar, Gjykata do të veprojë në bazë të nenit 46 të KPRK-se, në zëvendësimin e dënimit me gjobë me dënim me burgim duke llogaritur 20€ për një ditë të kaluar me burg.

Detyrohet i pandehuri që në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 20 euro, kurse për shpenzime të procedurës penale të paguaj shumën prej 40.88 € për ekspertizë të komunikacionit si dhe për ekspertizën mjeko-ligjore shumën 20.00 €, në afatin prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij Aktgjykimi.

E dëmtuara [REDAKTUAR] nga fshati [REDAKTUAR], Komuna [REDAKTUAR], për realizimin e kërkesës pasurore juridikë udhëzohet në kontest civil juridik.

### A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Ferizaj Departamenti i përgjithshëm, ka parashtruar Aktakuzën PP.II.nr.1334-2/2015, dt.19.12.2016, së bashku me kërkesën për shqiptimin e urdhrin ndëshkimor, kundër të akuzuarit, [REDAKTUAR] nga fshati [REDAKTUAR], Komuna [REDAKTUAR], për shkak të veprës penale Rrezikim i trafikut publik nga neni 378 par.6 lidhur me par.1 të KPRK-ës.

Gjykata shqyrtoj Aktakuzën dhe kërkesën për shqiptimin e urdhrin ndëshkimor dhe gjeti se Aktakuza dhe kërkesa janë të bazuar në baze të nenit 495 të KPP-se, gjeti se janë plotësuar kushtet nga neni 493 i KPP-ës, që pa u mbajtur shqyrtimi gjyqësor të merr vendim për urdhër ndëshkimorë si në dispozitiv, pasi që nga shkresat e lëndës vërtetohet se ka prova të mjaftueshme, të cilat vërtetojnë fajësinë e të akuzuarit se ka kryer veprën penale e cila i vihen në barrë sipas aktakuzës së Prokurorisë.

Gjykata, vlerëson se në rastin konkret ekzistojnë provat të cilat janë të mjaftueshme e për të vërtetuare fajësinë e të pandehurit, se ka kryer veprën penale e për të cilën ngarkohet, sipas aktakuzës së prokurorisë, kjo vërtetohet nga provat si vijojnë: lexohet konstatimi i ekspertit mjeko ligjor i datës 27.07.2016, mendimi i ekspertit të komunikacionit i datës 14.03.2016, deklarata e të pandehurit e datës 08.08.2015, deklarata e të dëmtuarit e datës 08.08.2015, si dhe të bëhet shiqimi në fotografitë të cilat gjenden në shkresat e lëndës të cilat vërtetojnë veprimet në kuptim të veprës penale me të cilën akuzohet i pandehuri.

Sipas KPRK-se, vepra penale Rrezikim i trafikut publik nga neni 378 par.6 lidhur me par. 1 të KPRK-ës është vepër penale e dënueshme me gjobë apo burgim deri në një (1) vit,

Gjykata në përputhje me nenin 73 të KPRK-së, me rastin e caktimit të lartësisë së dënimit me gjobë, mori për bazë gjendjen materiale dhe kushtet ekonomike për të akuzuarin, vlerësoj se një dënim i tillë është adekuat dhe është i përballueshëm në raport me gjendjen e tij ekonomike dhe me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit, i cili parashihet me nenin 41 të KPRK-ës, pasi që njëra nga qëllimet e dënimit është të parandalojë kryesin nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bejë rehabilitimin e tij dhe se të përmbajë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale.

Vendimin mbi shpenzimet e procedurës penale dhe paushallin gjyqësor, gjykata e mori komfor nenit 450 të KPP-ës.

Ne mbështetje te nenit 463 te KPP-se, palët e dëmtuara për realizimin e kërkesës pasurore juridikë janë udhëzuar ne kontestin civile juridik.

Nga theksimet e theksuara si me lartë u vendos si ne dispozitiv të këtij aktgjykimi

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ**  
**DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM-DIVIZIONI PENAL**  
**P.nr.1193/2016 dt.01.02.2017**



**Këshilla Juridike:** Kundër këtij aktgjykimi pala ka te drejtë kundërshtimi, ne afat prej 8 (tete) ditësh, nga dita e pranimi, kundërshtimi i parashtrohet kësaj gjykate.